



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.126

28 shtator

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.600, datë 12.9.2007	Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë	3571
Vendim i KM nr.605, datë 12.9.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e shpenzimeve për hapjen e kutive të votimit e të kutive të materialeve zgjedhore, të përdorura në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, 2007	3573
Vendim i KM nr.606, datë 12.9.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për komisionin qendror të zgjedhjeve, për financimin e zgjedhjeve të pjesshme parlamentare në zonën zgjedhore nr.31, Tiranë, më 23 shtator 2007	3574
Vendim i KM nr.607, datë 12.9.2007	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Vorë të qarkut të Tiranës	3574
Vendim i KM nr.608, datë 12.9.2007	Për transferimin në pronësi të bashkisë së Përrenjasit të kinoklubit të këtij qyteti	3575
Vendim i KM nr.610, datë 12.9.2007	Për transferimin e pasurive, troje dhe objekte, me interes vendor, në pronësi të bashkisë së Tiranës.....	3577
Vendim i KM	Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të	

nr.611, datë 12.9.2007	paluajtshme, pronë private, që preken nga rehabilitimi i shkarjeve, të ndodhura në Patos Fshat dhe Fratar.....	3588
Vendim i KM nr.612, datë 12.9.2007	Për dhënie fondi ndihmë Partisë së Punës së Shqipërisë, e riorganizuar.....	3593
Vendim i KM nr.618, datë 19.9.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Ujanik 2”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	3593
Vendim i KM nr.619, datë 19.9.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Radovë”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë.....	3594
Vendim i KM nr.621, datë 24.9.2007	Për financimin e fillimit të punimeve në segmentin rrugor Levan-Vlorë.....	3594
Kërkesë e MB nr.6001/1, datë 20.9.2007	Për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme të pronarëve, që preken nga zgjerimi i varrezave të qytetit, bashkia Pukë.....	3595
Kërkesë e MB nr.6003, datë 20.9.2007	Për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme të pronarëve, që preken nga “Përmirësimi i Unazës së Re”, Bashkia Tiranë....	3595

VENDIM
Nr.600, datë 12.9.2007

**PËR TRAJTIMIN ME STREHIM TË NËPUNËSVE CIVILË TË ADMINISTRATËS SË
LARTË SHTETËRORE DHE TË FUNKSIONARËVE POLITIKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 20 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit”, të nenit 30 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 12 të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 18 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7496, datë 3.7.1991 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kuptim të këtij vendimi, me funksionarë politikë dhe nëpunës civilë të administratës së lartë shtetërore, që trajtohen me strehim, nënkuptohen:

- a) Anëtarët e Këshillit të Ministrave;
- b) Deputetët;
- c) Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm;
- ç) Zëvendësministrat dhe personat e barazuar me ta, prefektët, dhe ushtarakët, me gradën e gjeneralit;
- d) Funksionarët politikë në kabinetet e Presidentit, të Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe të ministrave;
- dh) Titullarët e institucioneve qendrore e në varësi të Kryeministrit apo të ministrit, titullarët apo drejtuesit ekzekutivë, të institucioneve qendrore, të pavarura, si dhe të punësuarit në sektorin publik, në kuadër të projektit “Brain Gain”;
- e) Nëpunësit civilë të administratës qendrore, nga drejtor drejtorie deri te sekretar i përgjithshëm;
- ë) Familjet e policëve dhe të ushtarakëve të rënë në krye apo për shkak të detyrës.

2. Të gjitha subjekteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, gjatë kohës së ushtrimit të detyrës apo të funksionit shtetëror, të sipërpërmendur, kur kanë nevojë për strehim a sipërfaqe banimi shtesë, u lind e drejta të kërkojnë trajtim, me kredi, me kushte lehtësuese, nga shteti, për blerje banese apo sipërfaqe shtesë banimi, në vendin e ushtrimit të detyrës, që, në kuptim të këtij vendimi nënkupton territorin e rrethit, ku ndodhet selia administrative e organit, ku subjekti kryen funksionin a ushtron detyrën.

3. Trajtimi me kredi bëhet sipas marrëveshjes, së nënshkruar ndërmjet Ministrit të Financave, Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe bankës së përzgjedhur.

4. Listat për marrjen e kredive miratohen nga Kryeministri, me kërkesë të motivuar të ministrave dhe të institucioneve përkatëse dhe, më pas, dërgohen në bankën e përzgjedhur, e cila është e detyruar të respektojë renditjen e përcaktuar në këto lista.

5. Me nevojën për strehim a sipërfaqe banimi shtesë, sipas këtij vendimi, do të nënkuptojmë rastin kur subjekti nuk disponon ose disponon më pak sipërfaqe banimi se kuota minimale, konkretisht:

- a) Për strehim: kur ka 50 m² sipërfaqe banimi, subjekti i martuar dhe 42 m², subjekti beqar, i ve ose i divorcuar. Në sipërfaqen e banimit nuk përfshihen korridoret, wc-ja, ballkonet, tarraca dhe mjediset e tjera ndihmëse, të tilla si depo apo sheshpushime;
- b) Për sipërfaqe shtesë banimi, kur ka jo më pak se 14 m² për frymë, për çdo pasardhës, paraardhës apo person tjetër në ngarkim, që llogaritet sipas certifikatës së përbërjes familjare, të subjektit në çastin e aplikimit.

6. Subjekteve, të përcaktuara në pikat 1 e 5 të këtij vendimi, u lind e drejta për strehim apo për sipërfaqe shtesë banimi, kur:

- a) në vendin e ushtrimit të detyrës nuk kanë në pronësi të tyre, bashkëshortit/tes apo të çdo

pasardhësi, paraardhësi a personi tjetër në ngarkim, pasuri të paluajtshme për strehim, me sipërfaqe banimi, sipas kuotave të përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi;

b) nuk kanë në pronësi të tyre, bashkëshortit/tes apo të çdo pasardhësi, paraardhësi a personi tjetër në ngarkim, pasuri të paluajtshme, që përdoret për veprimtari tregtare, shërbimi e prodhimi;

c) ata, bashkëshorti/tja nuk janë pjesëtarë në veprimtari tregtare, sipas ligjit për shoqëritë tregtare, apo nuk përfitojnë të ardhura nga veprimtari ekonomike a veprimtari të tjera fitimprurëse profesionale, përfshi edhe mësimdhënien;

ç) nuk kanë në pronësi të tyre apo bashkëshortit/tes pasuri të luajtshme, mjete motorike për qarkullim në tokë/det/ajër, likiditete, tituj pronësie, përfshi edhe të drejta reale pasurore, me vlerë më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim;

d) kanë jo më pak se:

- 3 muaj vjetërsi në pozicionin e punës, sipas përcaktimeve të bëra në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” e “dh” të pikës 1 të këtij vendimi;

- 1 vit vjetërsi, pa ndërprerje, për pozicionet e përcaktuara në shkronjën “d” të pikës 1 të këtij vendimi;

- 2 vjet vjetërsi, pa ndërprerje, për pozicionet e përcaktuara në shkronjën “e” të pikës 1 të këtij vendimi.

7. Përzgjedhja e përfituesve të kredisë në ministritë dhe institucionet përkatëse bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga titullari i ministrisë a institucionit, i cili përcakton edhe strukturat përkatëse, brenda ministrisë apo institucionit, që shqyrtojnë kërkesat për kredi për strehim.

8. Çdo subjekt i interesuar, që kryen a ushtron njërën nga detyrat apo funksionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi dhe që gëzon të drejtën për strehim a sipërfaqe shtesë banimi, sipas këtij vendimi, duhet të paraqesë kërkesën, me shkrim, pranë titullarit të institucionit, ku ushtron detyrën, të shoqëruara me:

a) certifikatën e përbërjes familjare, në çastin e dorëzimit të kërkesës;

b) deklaratën për rrethanat, që mbështesin nevojën për strehim, sipas pikave 5 e 6 të këtij vendimi.

Për çdo deklaram, për të përfituar nga kredia lehtësuese, subjekti konfirmon vërtetësinë e tyre dhe pranon kushtin për konvertimin e drejtpërdrejtë të kredisë lehtësuese në kredi tregtare, kur vërtetohen pavërtetësi në deklaram dhe/ose rrethana të rreme.

Kopje e kësaj deklarate i vihet në dispozicion edhe institucionit bankar.

9. Kur gjatë apo pas zbatimit të kredisë rezultojnë se në kërkesë janë bërë deklarime të rreme, kredia konvertohet drejtpërdrejt në kredi tregtare, kusht i përcaktuar edhe në kontratën e kredisë. Institucioni bankar është i detyruar që diferencat e dhëna nga Buxheti i Shtetit për kreditë, të cilat konvertohen në kredi tregtare, t’ia kthejë përsëri Buxhetit.

Kryeministri shqyrton dhe miraton kërkesat e paraqitura nga ministritë dhe institucionet përkatëse.

10. Kredia për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore, jepet në vlerën deri në 5 milionë lekë, me interes 4 për qind, për strehim, dhe deri në 2.5 milionë lekë, me interes 4 për qind, për sipërfaqe shtesë banimi.

11. Kredimarrësit paraqesin pranë bankës dokumentacionin e nevojshëm, të përcaktuar nga vetë banka.

12. Buxheti i Shtetit financon diferencën e interesit të kredisë, sipas pikës 9 të këtij vendimi, me interesin e përcaktuar në marrëveshjen me bankën e përzgjedhur.

13. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit është përgjegjëse për mbajtjen e bazës së të dhënave, për planifikimin e fondeve të nevojshme dhe pagesën e subvencionit të banka e përzgjedhur, në çdo vit buxhetor.

14. Fondi i përcaktuar për këtë qëllim, i planifikuar në buxhetin vjetor të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, nuk duhet të jetë më shumë se 50 milionë lekë, duke filluar nga viti 2008 e në vazhdim, ndërsa numri i kredive të dhëna nuk duhet të jetë më shumë se 100 në vit.

15. Vendimi nr.102, datë 5.3.1999 i Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, shfuqizohet.

16. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Këshilli i Ministrave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.605, datë 12.9.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE PËR HAPJEN E KUTIVE TË VOTIMIT E TË KUTIVE TË MATERIALEVE ZGJEDHORE, TË PËRDORURA NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 2007

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’i shtohet fondi 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, për financimin e shpenzimeve për hapjen e kutive të votimit dhe të kutive të materialeve zgjedhore, të përdorura në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, 2007.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.606, datë 12.9.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PARLAMENTARE NË ZONËN ZGJEDHORE NR.31, TIRANË, MË 23 SHTATOR 2007

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t’i shtohet fondi 4 500 000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë, për financimin e zgjedhjeve të pjesshme parlamentare, në zonën zgjedhore nr.31, Tiranë, më 23 shtator 2007.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.607, datë 12.9.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË VORË, TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Vorë të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Vorë, të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.502, datë 19.7.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, në bashkinë Vorë të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Vorës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Vorë
Lidhje 1

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
2-13	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
14-17	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	Në pronësi
18, 37, 193-197, 500-521	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
20-31	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
38-54	Shërbim funeral	Në pronësi
19	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
56, 59-73, 79, 106-192	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës (troje)	Në përdorim
55, 57, 58, 74-78, 80-105, 198-262	Infrastrukturë (rrugë vendore lulishte, trotuar)	Në pronësi
446, 450, 452, 456, 459, 462, 464,	Prona që përdoren për ushtrimin e	Në pronësi

468, 473, 491-499

funksiioneve në fushën e bujqësisë
dhe të ushqimit (toka
joproduktive kanale të treta)

443-445, 447-449, 451, 453-455, 457,
458, 460-461, 463, 465-467, 469-472

Prona që përdoren për ushtrimin e
funksiioneve në fushën e bujqësisë
dhe të ushqimit (toka produktive)

Në përdorim

VENDIM
Nr.608, datë 12.9.2007

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË PËRRENJASIT TË KINOKLUBIT
TË KËTIJ QYTETI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “d”, 8 e 18 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të bashkisë së Përrenjasit të objektit “Kinoklubi i qytetit”, me sipërfaqe të përgjithshme 493 m², në zonën kadastrale 2924, me numër pasurie 2/47, për zhvillimin e veprimtarive social-kulturore.

2. Bashkisë së Përrenjasit i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kryetari i bashkisë Përrenjas, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE (Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Bashkia / Komuna : Prenjas		Identifikoi:		Irakli SHEGANI (Specialist) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Hymet KARRIQI (P.Z.Urbanistikës) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) Jordan MACOLLI (Kryetar Bashkie) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)						
Fusha e perdorimit te Prones: Kulturë - Histori - Sport		Supervizoi:								
		Aprovoi:								
A			B		C					
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdores Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
25	2924 C-3	1/237	Truall + Ndertesë	Qendra kulturore e fëmijëve. Bashkia Prenjas	273	120	Kulturë	Bashkia Prenjas	Bashkia Prenjas	Zënë nga banorë të komunitetit.
26	2924 D-3	2/102	Truall + Ndertesë	Ambiente sportive Bashkia Prenjas	85	85	Sport	Bashkia Prenjas	Bashkia Prenjas	
27	2924 D-3 E-3	2/108	Truall	Fushë futboll Bashkia Prenjas	8230		Sport	Bashkia Prenjas	Bashkia Prenjas	
28	2924 D-3	2/47	Truall + Ndertesë	Kinemaja e qytetit Bashkia Prenjas	493	493	Kulturë	Bashkia Prenjas	Bashkia Prenjas	
29	2924 C-4 D-4	5/7	Truall + Ndertesë	Ish këndi i lojreve Bashkia Prenjas	1278	1278	Kulturë	Bashkia Prenjas	Bashkia Prenjas	

VENDIM
Nr.610, datë 12.9.2007

**PËR TRANSFERIMIN E PASURIVE, TROJE DHE OBJEKTE, ME INTERES VENDOR, NË
PRONËSI TË BASHKISË SË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “k”, 5, 8 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e pasurive, truall dhe objekte, me nr.849, 864, 865, 898 e 983, në listën e pjesshme të inventarit (pjesa e parë), nr.2434 e 2863, në listën e pjesshme të inventarit (pjesa e dytë), dhe nr.100, në listën e pjesshme të inventarit (pjesa e tretë), në pronësi të Bashkisë së Tiranës, për ndërtimin e disa banesave sociale, në kuadër të strategjisë së strehimit, sipas formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Bashkisë së Tiranës nuk i lejohet tjetërsimi ose ndërrimi i destinacionit të këtyre pasurive apo dhënia në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)


1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
2428	8150 P-14	7/146	Shesh Publik		Rr. Sh. Ishmi	1358		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
2429	8150 P-14	7/149	Shesh Publik		Rr. Sh. Ishmi	98		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
2430	8150 P-14	7/150	Shesh Publik		Rr. Sh. Ishmi	95/44		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	Zënë nga banorë
2431	8150 P-14	7/148	Shesh Publik		Rr. Sh. Ishmi	457		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
2432	8150 P-14	7/160	Shesh Publik		Rr. Sh. Ishmi	469		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
2433	8150 P-14	8/187	Shesh Publik		Rr. Z. Curre	1654		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
2434	8150 P-14	8/199	Shesh Publik		Rr. A. Demi	2092		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
2435	8150 P-14	8/201	Shesh Publik		Rr. A. Demi	567		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	



3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
2860	8260 S,T-7,8	1/230	Shesh publik		Rr. I. Tomini	1647		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
2861	8260 S,T-7,8	1/231	Shesh publik		Rr. I. Tomini	1737		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
2862	8260 S,T-7,8	2/101	Shesh publik		Rr. I. Tomini	1733		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
2863	8260 S,T-7,8	1/210	Shesh publik		Rr. I. Tomini	1683		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
2864	8260 S,T-7,8	2/93	Shesh publik		Rr. I. Tomini	290		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
2865	8260 S,T-7,8	1/269	Shesh publik		Rr. I. Tomini	411/96		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	Zënë nga banorë
2866	8260 S,T-7,8	2/90	Shesh publik		Rr. I. Tomini	4412		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
2867	8260 S,T-7,8	2/32	Shesh publik		Rr. I. Tomini	4412		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	



3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
100	8210 N-9	4/53	Shesh Publik		Rr: "Duresit" Rr: "Muhamed Gjollësia"	1118		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
101	8210 N-9	4/84	Shesh Publik		Rr: "Duresit" Rr: "Muhamed Gjollësia"	1162		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
102	8210 N-9	4/76	Shesh Publik		Rr: "Duresit" Rr: "Muhamed Gjollësia"	517		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
103	8210 N-9	4/77	Shesh Publik		Rr: "Duresit" Rr: "Muhamed Gjollësia"	904		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
104	8310 N-9	3/31	Shesh Publik		Rr: "Duresit" Rr: "Muhamed Gjollësia"	819.7		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
105	8310 N-9	3/30	Shesh Publik		Rr: "Duresit" Rr: "Muhamed Gjollësia"	1180		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
106	8310 N-9	3/29	Shesh Publik		Rr: "Duresit" Rr: "Muhamed Gjollësia"	75.3		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	
107	8380 N-9	1/1	Shesh Publik		Rr: "Duresit" Rr: "Skenderbej"	361		Nd Nr 2 e Punt	Bashkia	

15

Chetani

REPUBLICA E SHQIPERISE


1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE (Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Identifikoi: Ing. R. Halidini, Top. H. Madani
Supervizor: Përgj. Sekt. Inventarizimit I, Dyporëku
Aprovi: Kryetar Edi Rama

Bashkia : Tirane

Fusha e perdorimit te Prones: Te tjera me interes vendor

Nr. Rënd.	A			B			Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni me pergjegesi administrative	Institucioni/Enti perdorues	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
	Zona Kadasir. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
849	8210 N-9	4/45	Ndertese	Banese shteterore Banese Rr. V. Manastiriti 2/4	192	177	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	Banese 2 kat
850	8210 N-9	6/16	Ndertese	Banese Rr. V. Manastiriti 13/1	196		Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	1 kat
851			Ndertese	Banese Rr B. Curri Nr 127			Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	1 kat Shembur
852	8210 O-9	6/200	Ndertese	Banese Rr N. Frasheri Nr 41/2	315	315	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	1 kat Shembur
853	8120 8130 J-14	10/144	Ndertese	Qendra Spitalore	755	449	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	1 kat



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE (Per inventarizimin e pronave te vecanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
862	8380 O-10	1/315	Ndertese	Banese Rr. K. Pezes Nr 42	154	82	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	1 kat
863	8250 Q-8	2/61	Ndertese	Banese Rr. K. Pezes Nr 24/1	20	20	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	1 kat
864	8350 N-9	1/14	Ndertese	Banese Rr. M. Peza 163	721	444	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	1 kat
865	8350 N-9	1/14	Ndertese	Banese Rr. M. Peza 145	721	444	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	1 kat
866	8350 M-9, N-9	1/136	Ndertese	Banese Rr. M. Peza 242	370	370	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	Pallat
867	8150 N-14	4/249	Ndertese	Banese Rr. A. Kasemi 62/1	54	49,1	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	1 kat
868	8150 M-14	4/248	Ndertese	Banese Rr. A. Kasemi 56/a	16,2	14,8	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	1 kat
869	8380 P-10	4/153	Ndertese	Banese Rr. I. Alla Nr 23	520	36,3	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	2 kat

Handwritten signature
 136
 11/11

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
894	8160 R-13	4/195 4/196		Banese Rr. Budi Nr 41	31,1	31,1	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	Kopsiti nr 41
895	8370 L-13	3/187		Banese Rr. 4 Deshmoret Nr 131	129	58,5	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	1 kat
896	8350 O-10	6/51	Ndertese	Banese Rr. S. Pashia nr 7	152	61,6	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	1 kat
897	8270 S-11	5/171	Ndertese	Banese Rr D' Distria Nr 5	573	52	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	2 kateshe
898	8360 N-11	6/68	Ndertese	Rr. M. Muco Nr 24	264	422	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	2 kateshe
899	8380 O-10	1/77 1/78	Ndertese	Banese Rr. M. Duri 101	315	38,5	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	1 kateshe
900	8170 K-16		Ndertese	Banese Rr. S. Petrela Nr 16			Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	1 kateshe
901	8380 P-11	6/91	Ndertese	Banese Rr. Rreshit çollaku Nr 38	150	82,7	Banim	Bashkia	Nd Nr 3 e Punt	1 kateshe


 Udhëheqësi
 Shërbimi
 14/11/2014
 14/11

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	8170 M.N.O-19 20.21.22	12/40								
	8170 M.N.O-19 20.21.22	12/40		Zyrtar+Magazina	Ish Komb. Aut Shkoze	120		Bashkia	URMM	
	8170 M.N.O-19 20.21.22	12/40		Dhoma e saldimit	Ish Komb. Aut Shkoze	14		Bashkia	URMM	
	8170 M.N.O-19 20.21.22	12/40		Sheshe+rruge	Ish Komb. Aut	9187		Bashkia	URMM	
383	8170 M.N-19, 20	10/19	Fonder-Mek sh.a		Ish Komb. Autotraktor Shkoze			Bashkia	Fon-Mek sh.a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Mag. Produktit te gatisjesh	Ish Komb. Aut Shkoze	1050		Bashkia	Fon-Mek sh.a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Zdruktitari	Ish Komb. Aut Shkoze	264		Bashkia	Fon-Mek sh.a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Mag. Zdrুক্তিতারিষে	Ish. Komb Aut Shkoze	200		Bashkia	Fon-Mek sh.a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Repartit Mekanik	Ish Komb. Aut Shkoze	8774		Bashkia	Fon-Mek sh.a	



184
A-11

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	8170 M.N-19, 20	10/19		Rep. Rula tamburo	Ish Komb Aut Shkoze	1375		Bashkia	Fon-Mek sh.a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Kaldaja	Ish Komb. Aut Shkoze	450		Bashkia	Fon-Mek sh.a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Paisje jashte standart.	Ish Komb. Aut Shkoze	840		Bashkia	Fon-Mek sh.a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Rep. Gizes sferoidale	Ish Komb. Aut Shkoze	561		Bashkia	Fon-Mek sh.a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Fondet e Gizes	Ish Komb. Aut Shkoze	7700		Bashkia	Fon-Mek sh.a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Rep. Modellet e Plasmalit	Ish komb. Aut Shkoze	400		Bashkia	Fon-Mek sh.a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Rep. Konacanes	Ish komb. Aut Shkoze	4056		Bashkia	Fon-Mek sh.a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Salla e kompresoreve 1	Ish komb. Aut Shkoze	280		Bashkia	Fon-Mek sh.a	

Shprehjet 185
Am

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)


1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	8170 M.N-19, 20	10/19		Salla e kompresoreve 2	Ish Komb. Aut Shkoze	360		Bashkia	Fon-Mek sh a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Mag lendes se pare	Ish Komb. Aut Shkoze	600		Bashkia	Fon-Mek sh a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Mag prane kompres	Ish Komb. Aut Shkoze	298		Bashkia	Fon-Mek sh a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Mag paisjeve elektrike	Ish Komb Aut Shkoze	438		Bashkia	Fon-Mek sh a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Mag rezervuarve te ujit	Ish Komb. Aut Shkoze	420		Bashkia	Fon-Mek sh a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Rep Modelet e drurit	Ish Komb. Aut Shkoze	930		Bashkia	Fon-Mek sh a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Mag kimikateve plasmalit	Ish Komb. Aut Shkoze	460		Bashkia	Fon-Mek sh a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Fonderia e celikut	Ish Komb. Aut Shkoze	7400		Bashkia	Fon-Mek sh a	

186
Dokumenti
Vole Hoxha
DPT

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	8170 M.N-19, 20	10/19		Rep. Kaoline	Ish Komb Aut Shkoze	280		Bashkia	Fon-Mek sh.a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Pajku I automjeleve	Ish Komb Aut Shkoze	580		Bashkia	Fon-Mek sh.a	
	8170 M.N-19, 20	10/19		Sheshe+ruge	Ish Komb Aut Shkoze	600		Bashkia	Fon-Mek sh.a	
984	8150 P-11 8150	1/127	Nd. Tregje Taksa	Kloska	Prane Bashkise 28 Nentori	530	Mbledhje taksa Zyre	Bashkia	Nd. Tre-Taksa	
	8340 O-12 8340	2/96 3/1		WC	Shenasi Dishnica 5 Maj	86 150	Nyje sanitare Nuk perdoret	Bashkia	Nd. Tre-Taksa	
	G.H-11,12 8260 Q.R-5.6	3/207		Ofiqine	Hamdi Pepa	114	Rep. Mirmbajije	Bashkia	Nd. Tre-Taksa	
	8310 L6.7K7	8/130		Treg Fruta Perime	P.Dardha	1875	Tregti fruta-per	Bashkia	Nd. Tre-Taksa	
	8230 S.T-1,2 U5.6	2/85		Treg Fruta Perime	Li.Miho	2400	Tregti fruta-per	Bashkia	Nd. Tre-Taksa	



187
[Handwritten signature]
[Handwritten initials]

VENDIM
Nr.611, datë 12.9.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REHABILITIMI I SHKARJEVE, TË NDODHURA
NË PATOS FSHAT DHE FRATAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rehabilitimi i shkarjeve, të ndodhura në Patos Fshat dhe Fratar.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 9673 m², tokë arë, të vlerësuar me çmimet 300 lekë/m², për zonën Patos Fshat, dhe 982 lekë/m², për zonën e Fratarit, me vlerë të përgjithshme 3 466 596 (tre milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, për sipërfaqen 189 m², tokë truall, të vlerësuar me çmimin 1000 lekë/ m², me vlerë të përgjithshme 189 000 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 3 655 596 (tre milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 445 000 (katërqind e dyzet e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit 3 655 596 (tre milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, të përballohet nga “Llogaria speciale”, e krijuar si transfertë kapitale për t’u përdorur për shpronësimet.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.9.2007 dhe të përfundojë më 15.10.2007.

7. Pronarët e përcaktuar në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni” a “Proces regjistrimi”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Qarku : Fier

Komuna : Patos

Fshati : Patos - Fshat

Lista e Pronareve qe preken nga rehabilitimi i rreshqitjeve ne, (Patos - Fshat).
Lloji i pasurise : Toke are dhe dru - frutor, nr.(1-17).

Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	Nr. i pas.	Toke bujq.			Totali	Shenime
					Siperfaqja m ²	Cmimi lek/m ²	Vlera /leke		
1	Fadil	Isuf	Resuli	6/18	650	300	195000	195000	Plotësim dokumentacioni
2	Flamur	Kadri	Resuli	6/17	364	300	109200	109200	Plotësim dokumentacioni
3	Pellumb	Kadri	Resuli	6/16	208	300	62400	62400	Plotësim dokumentacioni
4	Faik	Kadri	Resuli	6/15	156	300	46800	46800	Plotësim dokumentacioni
5	Kadri	Hasan	Resuli	6/14	351	300	105300	105300	Plotësim dokumentacioni
6	Pajtim	Rrapo	Malaj	6/10	850	300	255000	255000	Plotësim dokumentacioni
7	Hysni	Hekuran	Merkaj	6/8	540	300	162000	162000	Plotësim dokumentacioni
8	Nuri	Como	Kalemi	6/7	429	300	128700	128700	Plotësim dokumentacioni
9	Sefret	Nexhip	Kalemi	6/6	338	300	101400	101400	Plotësim dokumentacioni
10	Enver	Sefret	Beqiri	6/5	338	300	101400	101400	Plotësim dokumentacioni
11	Hasan	Sefret	Beqiri	6/4	481	300	144300	144300	Plotësim dokumentacioni
12	Bajram	Sefret	Beqiri	6/3	700	300	210000	210000	Plotësim dokumentacioni
13	Haki	Gjysho	Beqiri	6/2	420	300	126000	126000	Plotësim dokumentacioni
14	Luftar	Gjysho	Beqiri	6/1	2380	300	714000	714000	Plotësim dokumentacioni
15	Astrit	Como	Kamberi	5/50	640	300	192000	192000	Plotësim dokumentacioni
	Shuma				8845		2653500	2653500	

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Qarku : Fier

Komuna : Patos


Fshati : Fratar

Lista e Pronareve qe preken nga rehabilitimi i rreshqitjeve ne, (Fratar).
Lloji i pasurise : Toke are nr .(1-4).

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Toke bujq.			Truall			Totali	Shenime
				Nr. i pas.	Siperfaqja m2	cmimi lek / m2	Vlera leke	Sip. Truall	Cmimi /m2	Vlera Leka	
1	Shyqyri	Ramadan	Ymeraj	tapi	780	982	765960				Proces regjistrimi
2	Asllan	Jahja	Islami	tapi	28	982	27496				Proces regjistrimi
3	Ramadan	Fehim	Mustafaj	tapi	20	982	19640				Proces regjistrimi
4	Brahim	Musa	Filaj	555/1				189	1000	189000	Plotësim dokumentacioni
	Shuma				828		813096			189000	1002096

HOROGRAFI E ZONES

SH. 1:5000



REC. ARCHITECTURE TECHNICAL

MIN. R. TELCEZI

SAI

OBJEKTI STUDIUM PROJEKTUM MASA INZHINIERIKE		FAZA PROJEKT-ZBATIM
ZONA PATOS FSHAT		
PROJEKTOR	GENH. DUTIM SIPRAXI	
GRUPOR	GENH. LILIJANE	
SHTABETI		
FIRMA KONSULENTE "SAEL", TIRANE		1
KRETA 2005		Fletor

68

VENDIM
Nr.612, datë 12.9.2007

**PËR DHËNIE FONDI NDIHMË PARTISË SË PUNËS SË SHQIPËRISË,
E RIORGANIZUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000

“Për partitë politike”, të ndryshuar, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e një fondi prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh Partisë së Punës së Shqipërisë, të riorganizuar, si ndihmë financiare.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.618, datë 19.9.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “UJANIK 2”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006, “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Ujanik 2”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 6 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese për zgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Busa” sh.p.k.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.619, datë 19.9.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “RADOVË”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23 pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006, “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Radovë”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 6 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Tulla T” sh.p.k.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.621, datë 24.9.2007

PËR FINANCIMIN E FILLIMIT TË PUNIMEVE NË SEGMENTIN RRUGOR LEVAN-VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve), që, me fondet e TVSH-së, të programuara në buxhetin e vitit 2007, për projektin e rrugës Levan-Vlorë, të paguajë kontraktorin, me vlerën e paradhënies, në përputhje me kontratën e lidhur sipas standardeve të BERZH-it dhe BEI-it.
2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve) për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KËRKESË
Nr.6001/1, datë 20.9.2007

SHPLLJE KËRKESË PËR SHPRONËSIM

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme të pronarëve, që preken nga zgjerimi i varrezave të qytetit, bashkia Pukë.

Subjekti kërkuës është bashkia Pukë. Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni ka të bëjë me sipërfaqen që shpronësohet prej 2250 m². Ky publikim do të jetë për një periudhë 1-javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Brendshme. Fatura, sipas formatit të mësipërm, t'i dërgohet për likuidim bashkisë Pukë.

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONIT DHE PRONËN QË DO TË SHPRONËSOHET PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE TË QYTETIT, NË BASHKINË PUKË

Nr.	Prona që do të shpronësohet	Njësia e matjes	Sasia	Çmimi për njësi	Vlera në lekë	Emri i pronarit
1.	Tokë arë	m ²	1155	320	3 696 000	Halil Mus Laçi
2.	Tokë arë	m ²	892	320	285 440	Sherif Osman Laçi
3.	Tokë arë	m ²	178	320	56 960	Hamit Kapllan Laçi
	Shuma		2250		712 000	

KËRKESË
Nr.6003, datë 20.9.2007

SHPLLJE KËRKESË PËR SHPRONËSIM

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme të pronarëve, që preken nga "Përmirësimi i Unazës së Re", Bashkia Tiranë.

Subjekti kërkuës është Bashkia Tiranë. Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personin që preket nga ky shpronësim. Vënia në dijeni ka të bëjë me sipërfaqen që shpronësohet prej 3233 m². Ky publikim do të jetë për një periudhë 1-javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Brendshme. Fatura, sipas formatit të mësipërm, t'i dërgohet për likuidim Bashkisë Tiranë.

LISTA E PRONARËVE DHE VLERA NË LEKË SIPAS DOKUMENTEVE TË DORËZUARA
Rruga Unaza e Re (afër doganës)

Nr.	Emër, mbiemër	Zona kadastrale	Nr.Pas	Truall m ²	Çmimi (lekë)	Vlefë (lekë)
1.	Shkëndije Llagami	3866	215/73	608	12335	7499680
2.	Shkëndije Llagami	3866	215/49	760	12335	9374600
3.	Shkëndije Llagami	3866	301/59	700	12335	8634500
4.	Shkëndije Llagami	3866	301/183	700	12335	8634500
5.	Njazi Shijaku	8210	7/259	270	12335	3330450
6.	Zyhdi Saraçi	8210	7/271	160	12335	1973600
7.	Enver Dajti	3866	306/147	35	12335	431725
			Shuma	3233		
					Shuma	39,879,055

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME**

BOTIME TË REJA *(Të përditësuara gusht 2007)*

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 26.9.2007
Doli nga shtypi më 28.9.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 28 lekë